



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
LEZHË**

Lezhë më, 09.03.2026

**PROCESVERBAL I VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR PARAQITJEN E
KËRKESAVE PËR POZICIONIN E PUNËS “PUNONJËSE SHËRBBIMI”**

Bazuar në ligjin Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe mbi bazën e shtrukturës organike për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me qëllim plotësimin e një vendi vakant në strukturën e institucionit, përcaktuar me urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 21, datë 22.01.2026, në zbatim të neneve 74,75 dhe 76 pika 4 të ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me anë të Urdhërit Nr.06, datë 17.02.2026 ka urdhëruar fillimin e procedurës së konkurimit për pranim në organikë, për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “Punonjëse shërbim” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në kategorinë IV”.

Në vijim të procedurës me anë të urdhërit Nr. 06/1 datë 17.02.2026 është urdhëruar ngritja e komisionit për vlerësimin e kandidatëve për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “Punonjëse shërbim” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në kategorinë IV”.

Me datë 18.02.2026 është bërë shpallja e vendit vakant me kërkesat përkatëse në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe afishuar në tabelën e njoftimeve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Në njoftimin e lartpërmendur janë përcaktuar në mënyrë të detajuar kërkesat, që konkurentët duhet të plotësojnë, si dhe është përcaktuar data 03.03.2026 si afat përfundimtar për dorëzimin e dokumentave nga aplikantët.

Nga verifikimi në zyrën e Kryesekretarisë në lidhje me kërkesat për aplikim për këtë pozicion pune rezulton **se nuk u paraqit** asnjë kërkesë për vend pune të lirë në pozicionin “Punonjëse shërbim” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në kategorinë IV”.

Për sa më sipër, mbyllim procedurën e konkurimit për pranim në organikë, për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “Punonjëse shërbim” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në kategorinë IV”, nisur me urdhërin nr. 06 datë 17.02.2026 të zv. Drejtuesit të Prokurorisë, pasi nuk u paraqit asnjë kërkesë.

Me këtë procesverbal të njihet zv. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

KRYETARI I KOMISIONIT

Iva HARKA

ANËTAR I KOMISIONIT

Nikoleta MARKU

ANËTAR I KOMISIONIT

Nik NDOCA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
LEZHË

Lezhë, më :18 . 02 .2026

NJOFTIM
PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN E PUNËS “PUNONJËSE SHËRBIMI”

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë , duke u bazuar në Ligjin Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përmbushje të organikës Nr. 120/6 datë 26.01.2026 të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitin 2026 , me qëllim plotësimin e vendit vakant në strukturën e institucionit :

-Kërkon të punësojë 1 (një) punonjëse, gjinia femër në pozicionin e punës “Punonjëse shërbimi”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

NJOFTON:

Filimin e procedurës së hapur për konkurimin e kandidatëve të interesuar për pozicionin e punës “Punonjëse shërbimi”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë..

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data: 03.03.2026

Kandidatet e interesuara për tu pranuar për pozicionin e punës së lart përmendur duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të punës si më poshtë:

-Kushtet e përgjithshme :

- Të jetë shtetase shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe të mos jetë apo të mos ketë qënë nën hetim;
- Ndaj saj të mos jetë marrë masë disiplinore në marrëdhënie pune dhe/ose shërbim civil, që nuk është shuar sipas ligjit;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm.
- Të ketë njohuri mbi Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
- Të ketë njohuri mbi Ligjin Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

-Kushte të veçanta :

- Të ketë arsimin e mesëm
- Të ketë aftësi ndërvepruese të nivelit profesional me stafin e prokurorisë
- Të ketë aftësi komunikimi etik dhe profesional me publikun

Personat e interesuar duhet të paraqesin pranë sektetarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, deri më datë 03.03.2026 ora 16:00, dokumentat e kërkuara si më poshtë:

1. Kërkesë për punësim
2. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës
3. CV (jetëshkrim)
4. Diplomë e shkollës së mesme
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata, që nuk ndiqet penalisht
7. Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetsore
8. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimet e mëparshme.
9. Çdo lloj dokumenti tjetër që provon aftësitë e tij/saj profesionale

Konkurimi për pozicionin e punës “Punonjëse shërbimi”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, do të zhvillohet në dy faza:

Faza e parë: Verifikimi i dokumentave që do të bëhet nga Komisioni i ngritur me urdhërin Nr.06 /1 datë 17.02.2026 , me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në këtë njoftim, si dhe pikëzimi për dokumentacionin përkatës.

-Dokumentacioni maksimumi 60 pikë

Faza e dytë: Intervista e strukturuar me gojë.

-Intervista maksimumi 40 pikë

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet duke u bazuar në pikët e marra nga dokumentacioni i dorëzuar dhe ato të intervistës së strukturuar me gojë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, do të shpallë fituesin në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme ww.pp.gov.al.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJTHSHËM
LEZHË**